518	103/23	3752	RRUGË	SHTET	K-34-112-(165-C)(165-A)	MBROSTAR	Fier	Fier	2,280.20	219.00	33.00
519	105/12	3752	RRUGË	SHTET	K-34-112-(165-C)(165-A)	MBROSTAR	Fier	Fier	2,654.69	330.00	51.00
520	145	3752	KANAL	SHTET	K-34-112-(165-B)(165-D)	MBROSTAR	Fier	Fier	3,188.72	226.00	35.00
521	146	3752	RRUGË+KANAL	SHTET	K-34-112-(165-A)	MBROSTAR	Fier	Fier	14,420.09	976.00	153.00
522	149	3752	KANAL	SHTET	K-34-112-(165-C)(165-A)	MBROSTAR	Fier	Fier	2,437.79	296.00	46.00
523	150	3752	KANAL	SHTET	K-34-112-(165-A)(165-B,C)	MBROSTAR	Fier	Fier	1,967.10	254.00	39.00
524	179	3752	KANAL	SHTET	K-34-112-(149-C)(148-D)	MBROSTAR	Fier	Fier	7,070.24	468.00	72.00
525	182	3752	RRUGË+KANAL	SHTET	K-34-112-(149-C)(148-D)	MBROSTAR	Fier	Fier	24,606.68	457.00	70.00
526	191	3752	KANAL	SHTET	K-34-112-(165-A)	MBROSTAR	Fier	Fier	5,717.34	338.00	52.00
527	241	3752	KANAL	SHTET	K-34-112-(164-B)(165-A)	MBROSTAR	Fier	Fier	2,864.69	157.00	-
528	242	3752	KANAL	SHTET	K-34-112-(165-A)(165-C)	MBROSTAR	Fier	Fier	6,344.22	397.00	61.00
529	43/30	3752	RRUGË	SHTET	K-34-112-(165-A)	MBROSTAR	Fier	Fier	13,189.29	424.00	65.00
530	55/20	3752	RRUGË	SHTET	K-34-112-(165-A)	MBROSTAR	Fier	Fier	2,257.38	286.00	44.00
531	56/26	3752	RRUGË	SHTET	K-34-112(165-A)(165-C)	MBROSTAR	Fier	Fier	2,967.79	340.00	54.00
532	57/28	3752	RRUGË	SHTET	K-34-112-(165-B)(165-A)	MBROSTAR	Fier	Fier	4,757.94	1,749.00	269.00
533	58/14	3752	RRUGË	SHTET	K-34-112-(165-A)	MBROSTAR	Fier	Fier	2,534.77	239.00	37.00
534	81/20	3752	RRUGË	SHTET	K-34-111-(216-B)	MBROSTAR	Fier	Fier	3,200.41	431.00	66.00
535	377	1145	KANAL	SHTET	K-34-114-(250-B)	QENDËR BULGARËC	Korçë	Korçë	10,967.86	383.00	59.00
536	388	1145	RRUGË	SHTET	K-34-114-(250-B)	QENDËR BULGARËC	Korçë	Korçë	13,456.11	777.00	124.00
537	412	1145	KANAL	SHTET	K-34-114-(250-B)	QENDËR BULGARËC	Korçë	Korçë	3,332.49	261.00	-
538	55/28	1145	KANAL	SHTET	K-34-114-(250-B)	QENDËR BULGARËC	Korçë	Korçë	1,713.23	428.00	66.00
539	174	1310	KANAL	SHTET	K-34-126-(24-B)	QENDËR BULGARËC	Korçë	Korçë	10,450.07	922.00	142.00
540	190	1310	KANAL	SHTET	K-34-126-(24-B)	QENDËR BULGARËC	Korçë	Korçë	5,457.42	518.00	80.00
541	191	1310	KANAL	SHTET	K-34-126-(24-B)	QENDËR BULGARËC	Korçë	Korçë	2,327.28	225.00	34.00
542	192	1310	KANAL	SHTET	K-34-126-(24-B)	QENDËR BULGARËC	Korçë	Korçë	1,658.20	345.00	53.00
543	193	1310	KANAL	SHTET	K-34-126-(24-B)	QENDËR BULGARËC	Korçë	Korçë	10,111.92	629.00	96.00
544	208	1310	KANAL	SHTET	K-34-126-(24-B)	QENDËR BULGARËC	Korçë	Korçë	4,923.57	74.00	-
545	211	1310	KANAL	SHTET	K-34-126-(24-B)	QENDËR BULGARËC	Korçë	Korçë	1,341.38	255.00	39.00
546	344	1403	RRUGË+KANAL	SHTET	K-34-126-(25-A)	QENDËR BULGARËC	Korçë	Korçë	9,175.92	240.00	37.00
547	286	1403	KANAL	SHTET	KO-CIFL-55	QENDËR BULGARËC	Korçë	Korçë	2,420.29	237.00	36.00
548	287	1403	KANAL	SHTET	KO-CIFL-55	QENDËR BULGARËC	Korçë	Korçë	2,963.61	431.00	65.00
549	295	1403	KANAL	SHTET	K-34-126-(9-D)	QENDËR BULGARËC	Korçë	Korçë	4,064.98	659.00	109.00
550	319	1403	KANAL	SHTET	K-34-126-(9-C)	QENDËR BULGARËC	Korçë	Korçë	802.76	561.00	47.00
551	322	1403	KANAL	SHTET	K-34-126-(25-A)	QENDËR BULGARËC	Korçë	Korçë	4,387.64	495.00	76.00
552	335	1403	KANAL	SHTET	K-34-126-(25-A)	QENDËR BULGARËC	Korçë	Korçë	3,758.30	268.00	42.00
553	439	1491	PËRRUA	SHTET	K-34-114-250-C	QENDËR BULGARËC	Korçë	Korçë	5,296.13	616.00	91.00
554	38/18	1631	RRUGË	SHTET	K-34-126-(119-B)	MOLLAJ	Korçë	Korçë	2,102.68	298.00	-
555	83/14	1631	RRUGË	SHTET	K-34-126-(119-B)	MOLLAJ	Korçë	Korçë	7,384.47	1,533.00	223.00

556	1112	1631	RRUGË	SHTET	K-34-126-(119-AB	MOLLAJ	Korçë	Korçë	24,148.84	1,397.00	209.00
557	1119	1631	RRUGË	SHTET	K-34-126-(103-D)	MOLLAJ	Korçë	Korçë	1,428.55	460.00	71.00
558	1120	1631	RRUGË	SHTET	K-34-126-(103-D)	MOLLAJ	Korçë	Korçë	8,189.03	1,894.00	190.00
559	1121	1631	LUMË	SHTET	K-34-126-(103-D)	MOLLAJ	Korçë	Korçë	12,370.53	2,876.00	338.00
560	1149	1631	KANAL	SHTET	K-34-126-(119-B)	MOLLAJ	Korçë	Korçë	2,932.02	435.00	66.00
561	1153	1631	PËRRUA	SHTET	K-34-126-(119-A)	MOLLAJ	Korçë	Korçë	32,828.55	1,149.00	171.00
562	1155	1631	PËRRUA	SHTET	K-34-126-(119-A)	MOLLAJ	Korçë	Korçë	7,646.81	913.00	140.00
563	1158	1631	PËRRUA	SHTET	K-34-126-(119-A)	MOLLAJ	Korçë	Korçë	4,277.60	4,186.00	587.00
564	1160	1631	KANAL	SHTET	K-34-126-(119-B)	MOLLAJ	Korçë	Korçë	838.95	665.00	16.00
565	1161	1631	KANAL	SHTET	126 (119A, 119C)	MOLLAJ	Korçë	Korçë	3,724.98	185.00	27.00
566	1175	1631	LUMË	SHTET	126 (119B, 119D)	MOLLAJ	Korçë	Korçë	15,542.05	821.00	123.00
567	19	1631	PËRRUA	SHTET	K-34-126-(103-D)	MOLLAJ	Korçë	Korçë	3,547.35	152.00	-
568	68/25	1631	KANAL	SHTET	K-34-126-(119-B)	MOLLAJ	Korçë	Korçë	674.37	175.00	27.00
569	70/3	1631	KËNETË	SHTET	K-34-126-(119-B)	MOLLAJ	Korçë	Korçë	5,563.27	645.00	68.00
570	11/30	2063	RRUGË	SHTET	K-34-126-(87-D)	MOLLAJ	Korçë	Korçë	2,680.09	266.00	41.00
571	25/49	2063	KANAL	SHTET	K-34-126-(87-D)	MOLLAJ	Korçë	Korçë	844.43	364.00	56.00
572	10/45	2063	KANAL	SHTET	K-34-126-(87-D)	MOLLAJ	Korçë	Korçë	1,363.33	392.00	96.00
573	845	2063	RRUGË+KANAL	SHTET	K-34-126-(103-B)	MOLLAJ	Korçë	Korçë	3,684.31	189.00	-
574	846	2063	RRUGË+KANAL	SHTET	K-34-126-(87-D)	MOLLAJ	Korçë	Korçë	6,596.78	253.00	39.00
575	847	2063	KANAL	SHTET	K-34-126-(87-D)	MOLLAJ	Korçë	Korçë	2,856.03	265.00	41.00
576	851	2063	KANAL	SHTET	K-34-126-(103-B)	MOLLAJ	Korçë	Korçë	6,295.17	836.00	129.00
577	355	2307	KANAL	SHTET	K-34-114-(251-D)	QENDËR BULGARËC	Korçë	Korçë	21,486.61	2,142.00	330.00
578	358	2307	KANAL	SHTET	K-34-114-(251-D)	QENDËR BULGARËC	Korçë	Korçë	835.86	341.00	52.00
579	371	2307	KANAL	SHTET	K-34-114-(251-D)	QENDËR BULGARËC	Korçë	Korçë	10,897.39	756.00	116.00
580	376	2307	KANAL	SHTET	K-34-114-(251-D)	QENDËR BULGARËC	Korçë	Korçë	11,623.66	632.00	97.00
581	438	2307	KANAL	SHTET	K-34-114-(251-D)	QENDËR BULGARËC	Korçë	Korçë	35,072.37	904.00	139.00
582	432/14	2426	RRUGË	SHTET	K-34-126-(117-A)	VITHKUQ	Korçë	Korçë	2,339.96	111.00	-
583	432/15	2426	KANAL	SHTET	K-34-126-(117-A)	VITHKUQ	Korçë	Korçë	1,624.78	111.00	-
584	368/12	2426	KANAL	SHTET	K-34-126-(117-A)	VITHKUQ	Korçë	Korçë	1,740.84	277.00	46.00
585	368/14	2426	KANAL	SHTET	K-34-126-(117-A)	VITHKUQ	Korçë	Korçë	1,169.78	1,170.00	-
586	368/16	2426	KANAL	SHTET	K-34-126-(117-A)	VITHKUQ	Korçë	Korçë	2,797.01	260.00	56.00
587	369/13	2426	KANAL	SHTET	K-34-126-(117-A)	VITHKUQ	Korçë	Korçë	4,358.88	1,369.00	176.00
588	370/11	2426	KANAL	SHTET	K-34-126-(117-A)	VITHKUQ	Korçë	Korçë	1,303.00	23.00	-
589	370/12	2426	RRUGË	SHTET	K-34-126-(117-A)	VITHKUQ	Korçë	Korçë	618.96	12.00	-
590	370/7	2426	RRUGË	SHTET	K-34-126-(117-A)	VITHKUQ	Korçë	Korçë	582.68	507.00	-
591	370/8	2426	KANAL	SHTET	K-34-126-(117-A)	VITHKUQ	Korçë	Korçë	1,339.01	24.00	-
592	371/16	2426	KANAL	SHTET	K-34-126-(117-A)	VITHKUQ	Korçë	Korçë	1,730.05	587.00	90.00
593	371/17	2426	RRUGË	SHTET	K-34-126-(117-A)	VITHKUQ	Korçë	Korçë	1,338.02	420.00	57.00
594	371/18	2426	KANAL	SHTET	K-34-126-(117-A)	VITHKUQ	Korçë	Korçë	1,481.68	11.00	-
595	371/19	2426	KANAL	SHTET	K-34-126-(117-A)	VITHKUQ	Korçë	Korçë	2,666.22	285.00	-
596	502	2426	LUMË	SHTET	K-34-126-(117-A)	VITHKUQ	Korçë	Korçë	85,306.34	1,619.00	255.00
597	531	2426	LUMË	SHTET	K-34-126-(117-B)	VITHKUQ	Korçë	Korçë	19,833.15	3,234.00	153.00
598	550	2426	MAL	SHTET	K-34-126-(117-D)	VITHKUQ	Korçë	Korçë	799,364.65	6,940.00	658.00
599	562	2426	MAL	SHTET	K-34-126-(117-C)	VITHKUQ	Korçë	Korçë	1,219,380.75	7,947.00	1,223.00
600	454	2560	KANAL	SHTET	K-34-126-(10 -A)	QENDËR BULGARËC	Korçë	Korçë	4,910.87	529.00	81.00
601	139/36	2984	RRUGË	SHTET	K-34-114-(235-C)	POJAN	Maliq	Korçë	2,259.02	84.00	-
602	139/38	2984	RRUGË	SHTET	K-34-114-(235-C)	POJAN	Maliq	Korçë	2,855.95	501.00	51.00
603	138/59	2984	RRUGË	SHTET	K-34-114-(235-C)	POJAN	Maliq	Korçë	3,047.57	309.00	47.00
604	138/60	2984	RRUGË	SHTET	K-34-114-(235-C)	POJAN	Maliq	Korçë	1,518.36	216.00	33.00
605	138/71	2984	RRUGË	SHTET	K-34-114-(235-C)	POJAN	Maliq	Korçë	2,968.10	401.00	58.00
606	395	2984	KANAL	SHTET	K-34-114-(235-B)	POJAN	Maliq	Korçë	1,226.89	396.00	61.00

607	397	2984	KANAL	SHTET	K-34-114-(235-C)	POJAN	Maliq	Korçë	4,044.25	464.00	71.00
608	398	2984	KANAL	SHTET	K-34-114-(235-C)	POJAN	Maliq	Korçë	4,347.42	362.00	56.00
609	399	2984	KANAL	SHTET	K-34-114-(235-D)	POJAN	Maliq	Korçë	6,310.99	443.00	68.00
610	452	2984	KANAL	SHTET	K-34-114-(235-C)	POJAN	Maliq	Korçë	3,974.53	523.00	84.00
611	456	2984	KANAL	SHTET	K-34-114-(235-D)	POJAN	Maliq	Korçë	2,841.05	343.00	53.00
612	457	2984	KANAL	SHTET	K-34-114-(235-D)	POJAN	Maliq	Korçë	4,213.24	380.00	58.00
613	458	2984	KANAL	SHTET	K-34-114-(235-D)	POJAN	Maliq	Korçë	10,560.56	461.00	71.00
614	460	2984	KANAL	SHTET	K-34-114-(235-D)	POJAN	Maliq	Korçë	5,502.90	541.00	82.00
615	66/35	2984	RRUGË	SHTET	K-34-114-(235-D)	POJAN	Maliq	Korçë	2,767.18	169.00	26.00
616	67/29	2984	RRUGË	SHTET	K-34-114-)235-D)	POJAN	Maliq	Korçë	2,188.74	170.00	26.00
617	68/38	2984	RRUGË	SHTET	K-34-114-(235-D)	POJAN	Maliq	Korçë	7,163.73	518.00	81.00
618	68/39	2984	RRUGË	SHTET	K-34-114-(235-D)	POJAN	Maliq	Korçë	2,024.14	181.00	28.00
619	230/39	3016	RRUGË	SHTET	K-34-126-(55-D)	VOSKOP	Korçë	Korçë	2,142.76	345.00	57.00
620	229/37	3016	RRUGË	SHTET	K-34-126-(55-D)	VOSKOP	Korçë	Korçë	2,652.07	234.00	36.00
621	378	3016	RRUGË	SHTET	K-34-126-(55-A)	VOSKOP	Korçë	Korçë	18,046.90	373.00	57.00
622	381	3016	KANAL	SHTET	K-34-126-(55-A)	VOSKOP	Korçë	Korçë	1,447.47	270.00	41.00
623	68/39	3016	RRUGË	SHTET	K-34-126-(55-D)	VOSKOP	Korçë	Korçë	1,922.98	195.00	30.00
624	115/14	3071	KANAL	SHTET	K-34-126-(103-B)	MOLLAJ	Korçë	Korçë	2,569.01	432.00	67.00
625	119/25	3071	RRUGË	SHTET	K-34-126-(103-D)	MOLLAJ	Korçë	Korçë	3,904.86	216.00	39.00
626	152	3071	PËRRUA	SHTET	K-34-126-(87-C)	MOLLAJ	Korçë	Korçë	12,272.26	857.00	127.00
627	170	3071	RRUGË+KANAL	SHTET	K-34-126-(103-B)	MOLLAJ	Korçë	Korçë	12,817.59	819.00	127.00
628	184	3071	PËRRUA	SHTET	K-34-126-(103-B)	MOLLAJ	Korçë	Korçë	30,179.22	2,454.00	350.00
629	190	3071	RRUGË	SHTET	K-34-126-(103-B)	MOLLAJ	Korçë	Korçë	2,572.63	436.00	69.00
630	433	3157	RRUGË	SHTET	K-34-126-(40-C)	DRENOVË	Korçë	Korçë	3,981.58	307.00	47.00
631	435	3157	KANAL	SHTET	K-34-126-(40-C)	DRENOVË	Korçë	Korçë	957.08	82.00	11.00
632	11	3193	RRUGË	SHTET	K-34-126-(117-D)	VITHKUQ	Korçë	Korçë	1,484,687.95	522.00	-
633	463	3437	RRUGË	SHTET	K-34-126-(97-D)	VITHKUQ	Korçë	Korçë	17,889.24	700.00	119.00
634	467	3437	RRUGË	SHTET	K-34-126-(113-B)	VITHKUQ	Korçë	Korçë	14,155.40	4,477.00	484.00
635	471	3437	PËRRUA	SHTET	K-34-26-(114-C)	VITHKUQ	Korçë	Korçë	12,406.30	604.00	-
636	475	3437	PËRRUA	SHTET	K-34-26-(114-C)	VITHKUQ	Korçë	Korçë	40,260.16	1,799.00	340.00
637	390	3660	KANAL	SHTET	K-34-126-(41-A)	DRENOVË	Korçë	Korçë	5,357.20	1,099.00	205.00
638	394	3660	RRUGË	SHTET	K-34-126-(40-B)	DRENOVË	Korçë	Korçë	8,114.08	510.00	77.00
639	397	3660	RRUGË	SHTET	K-34-126-(40-B)	DRENOVË	Korçë	Korçë	10,147.31	1,193.00	183.00
640	408	3660	KËNETË	SHTET	K-34-126-(40-B)	DRENOVË	Korçë	Korçë	8,080.21	45.00	-
641	281/63	3668	KANAL	SHTET	K-34-126-(103-D)	MOLLAJ	Korçë	Korçë	764.43	300.00	46.00
642	447	3818	KANAL	SHTET	K-34-126-(39-D)	VOSKOP	Korçë	Korçë	5,303.10	281.00	43.00
643	450	3818	RRUGË	SHTET	K-34-126-(56-A)	VOSKOP	Korçë	Korçë	21,391.15	310.00	47.00
644	453	3818	RRUGË	SHTET	K-34-126-(56-A)	VOSKOP	Korçë	Korçë	7,311.01	655.00	101.00
645	118/90	3903	RRUGË	SHTET	K-34-114-(236-B)	POJAN	Maliq	Korçë	792.61	330.00	44.00
646	104/2/19	3903	RRUGË	SHTET	K-34-114-(236-B)	POJAN	Maliq	Korçë	2,383.21	296.00	45.00
647	109/39	3903	RRUGË	SHTET	K-34-114-(237-A)	POJAN	Maliq	Korçë	3,652.25	66.00	-
648	110/80	3903	RRUGË	SHTET	K-34-114-(237-A)	POJAN	Maliq	Korçë	3,124.56	564.00	42.00
649	157/90	3903	RRUGË	SHTET	K-34-114-(237-A)	POJAN	Maliq	Korçë	1,045.83	332.00	41.00
650	201	3903	RRUGË+KANAL	SHTET	K-34-114-(236-A)	POJAN	Maliq	Korçë	27,788.20	1,178.00	173.00
651	203	3903	RRUGË	SHTET	K-34-114-(236-B)	POJAN	Maliq	Korçë	20,938.34	1,098.00	168.00
652	230	3903	KANAL	SHTET	K-34-114-(236-C)	POJAN	Maliq	Korçë	10,446.91	738.00	113.00
653	252	3903	RRUGË+KANAL	SHTET	K-34-114-(237-A)	POJAN	Maliq	Korçë	10,393.47	166.00	-
654	276	3903	RRUGË	SHTET	K34-114-(236,237)	POJAN	Maliq	Korçë	37,857.01	631.00	97.00
655	293	3903	RRUGË	SHTET	K-34-114-(237-A)	POJAN	Maliq	Korçë	1,743.27	622.00	105.00
656	295	3903	KANAL	SHTET	K-34-114-(237-A)	POJAN	Maliq	Korçë	5,143.07	376.00	70.00
657	297	3903	KANAL	SHTET	K-34-114-(237-A)	POJAN	Maliq	Korçë	4,360.07	28.00	-

658	298	3903	KANAL	SHTET	K-34-114-(237-A)	POJAN	Maliq	Korçë	3,030.53	272.00	37.00
659	299	3903	RRUGË+KANAL	SHTET	K-34-114-(237-A)	POJAN	Maliq	Korçë	2,109.69	212.00	-
660	312	3903	KANAL	SHTET	K-34-114-(237-A)	POJAN	Maliq	Korçë	14,092.46	1,518.00	257.00
661	314/9	3903	KANAL	SHTET	KO-ZEMB-55	POJAN	Maliq	Korçë	1,030.79	241.00	43.00
662	315	3903	KANAL	SHTET	K-34-114-(236-B)	POJAN	Maliq	Korçë	2,932.98	308.00	47.00
663	75/2/8	3903	RRUGË	SHTET	K-34-114-(236-A)	POJAN	Maliq	Korçë	927.76	315.00	-
664	75/4	3903	KANAL	SHTET	K-34-114-(236-A)	POJAN	Maliq	Korçë	1,212.65	348.00	91.00
665	75/5	3903	KANAL	SHTET	K-34-114-(236-A)	POJAN	Maliq	Korçë	2,067.17	17.00	-
666	91	3903	RANISHTE	SHTET	K-34-114-(237-B)	POJAN	Maliq	Korçë	496.05	163.00	27.00
667	31/22	8564	KANAL	SHTET	K-34-126-(25-A)	KORÇË	Korçë	Korçë	569.11	234.00	36.00
668	44/23	8564	RRUGË	SHTET	K-34-126-(24-D)	KORÇË	Korçë	Korçë	3,311.28	340.00	52.00
669	47/1	8564	RRUGË	SHTET	K-34-126-(25-C)	KORÇË	Korçë	Korçë	4,126.22	304.00	47.00
670	48/35	8564	RRUGË	SHTET	K-34-126-(25-C)	KORÇË	Korçë	Korçë	4,044.24	333.00	51.00
671	49/42	8564	KANAL	SHTET	K-34-126-(25-C)	KORÇË	Korçë	Korçë	1,116.90	458.00	70.00
672	471/17	1295	RRUGË	SHTET	K-34-112-(150-C)	BUBULLIMË	Lushnjë	Lushnjë	3,541.75	591.00	88.00
673	224/11	1984	RRUGË	SHTET	K-34-112-(150-C)	BUBULLIMË	Lushnjë	Lushnjë	6,717.14	490.00	76.00
674	225/21	1984	RRUGË	SHTET	K-34-112-(166-B)	BUBULLIMË	Lushnjë	Lushnjë	16,140.75	519.00	74.00
675	227/16	1984	RRUGË	SHTET	K-34-112-(166-B)	BUBULLIMË	Lushnjë	Lushnjë	1,622.92	122.00	16.00
676	228/17	1984	RRUGË	SHTET	K-34-112-(166-B)	BUBULLIMË	Lushnjë	Lushnjë	2,911.11	188.00	30.00
677	229/11	1984	RRUGË	SHTET	K-34-112-(166-D)	BUBULLIMË	Lushnjë	Lushnjë	7,727.55	493.00	75.00
678	230/9	1984	RRUGË	SHTET	K-34-112-(166-B)	BUBULLIMË	Lushnjë	Lushnjë	2,521.14	217.00	33.00
679	231/11	1984	RRUGË	SHTET	K-34-112-(166-D)	BUBULLIMË	Lushnjë	Lushnjë	4,391.67	563.00	87.00
680	388	1984	RRUGË	SHTET	K-34-112-(166-B)	BUBULLIMË	Lushnjë	Lushnjë	46,782.66	1,241.00	193.00
681	390	1984	RRUGË	SHTET	K-34-112-(166-B)	BUBULLIMË	Lushnjë	Lushnjë	7,566.28	393.00	58.00
682	392	1984	RRUGË	SHTET	K-34-112-(166-D)	BUBULLIMË	Lushnjë	Lushnjë	6,004.26	589.00	91.00
683	100	1342	LUMË	SHTET	K-34-125-(102-D)	QENDËR SKRAPAR	Skrapar	Skrapar	63,441.42	5,364.00	576.00
684	115	1342	LUMË	SHTET	K-34-125-(102-C)	QENDËR SKRAPAR	Skrapar	Skrapar	189,534.67	11,375.00	1,495.00
685	131	1342	RRUGË	SHTET	K-34-125-(102-C)	QENDËR SKRAPAR	Skrapar	Skrapar	47,434.52	1,466.00	74.00
686	38/7	1373	RRUGË	SHTET	K-34-125-(136-B)	QENDËR SKRAPAR	Skrapar	Skrapar	24,611.64	167.00	-
687	56	1373	RRUGË	SHTET	K-34-125-(136-B)	QENDËR SKRAPAR	Skrapar	Skrapar	10,721.78	347.00	-
688	55/1	1420	RRUGË	SHTET	K-34-125-(136-B)	ÇOROVODË	Skrapar	Skrapar	2,004.37	402.00	60.00
689	55/10	1420	RRUGË	SHTET	K-34-125-(136-B)	ÇOROVODË	Skrapar	Skrapar	1,889.40	758.00	55.00
690	55/22	1420	RRUGË	SHTET	K-34-125-(136-B)	ÇOROVODË	Skrapar	Skrapar	7,994.55	473.00	72.00
691	61/62	1420	LUMË	SHTET	K-34-125-(136-A)	ÇOROVODË	Skrapar	Skrapar	13,832.05	211.00	24.00
692	61/63	1420	LUMË	SHTET	K-34-125-(136-A)	ÇOROVODË	Skrapar	Skrapar	15,933.08	1,256.00	193.00
693	61/65	1420	RRUGË	SHTET	K-34-125-(136-A)	ÇOROVODË	Skrapar	Skrapar	3,969.62	516.00	86.00
694	62/19	1420	RRUGË	SHTET	K-34-125-(136-A)	ÇOROVODË	Skrapar	Skrapar	2,850.83	280.00	36.00
695	62/22	1420	RRUGË	SHTET	K-34-125-(136-A)	ÇOROVODË	Skrapar	Skrapar	586.50	170.00	30.00
696	197	2739	RRUGË	SHTET	K-34-125-(119-D)	QENDËR	Skrapar	Skrapar	3,894.18	1,818.00	71.00
697	67	1420	LUMË	SHTET	K-34-125-(119-D)	ÇOROVODË	Skrapar	Skrapar	164,004.39	44,369.00	7,504.00
698	162/7	3037	RRUGË	SHTET	K-34-125-(124-D)	POTOM	Skrapar	Skrapar	581.46	12.00	-
699	464	3037	RRUGË	SHTET	K-34-125(139-A)	POTOM	Skrapar	Skrapar	21,749.26	11,274.00	1,489.00
700	465	3037	RRUGË	SHTET	K-34-125(139-A)	POTOM	Skrapar	Skrapar	1,463.12	342.00	58.00
701	68	3076	RRUGË	SHTET	K-34-125-(138-B)	POTOM	Skrapar	Skrapar	31,788.35	5,437.00	244.00
702	73	3076	RRUGË	SHTET	K-34-125-(139-A)	POTOM	Skrapar	Skrapar	1,026.20	31.00	-
703	5/81	3322	RRUGË	SHTET	K-34-125-(136-A)	QENDËR SKRAPAR	Skrapar	Skrapar	555.97	238.00	39.00
704	5/95	3322	RRUGË	SHTET	K-34-125-(136-A)	QENDËR SKRAPAR	Skrapar	Skrapar	1,305.13	248.00	39.00
705	353/4	3596	PA FRYT	SHTET	K-34-125-(117-A)	VENDRESHË	Skrapar	Skrapar	445.90	389.00	65.00
706	356	3596	PA FRYT	SHTET	K-34-125-(117-A)	VENDRESHË	Skrapar	Skrapar	644.30	273.00	-
707	402	3596	KANAL	SHTET	125-(101-C-117-A)	VENDRESHË	Skrapar	Skrapar	42,657.65	13,788.00	4,311.00
708	251	3596	PA FRYT	SHTET	K-34-125-(101-D)	VENDRESHË	Skrapar	Skrapar	1,317.70	1,316.00	282.00

709	273/10	3596	PA FRYT	SHTET	K-34-125-(101-D)	VENDRESHË	Skrapar	Skrapar	1,871.04	676.00	63.00
710	355	3596	PA FRYT	SHTET	K-34-125-(117-A)	VENDRESHË	Skrapar	Skrapar	1,937.05	123.00	-
711	403	3596	RRUGË	SHTET	125-(117-A-101-C)	VENDRESHË	Skrapar	Skrapar	18,480.22	490.00	72.00
712	412	3596	RRUGË	SHTET	K-34-125-(100-B)	VENDRESHË	Skrapar	Skrapar	841.49	787.00	-
713	206	3739	RRUGË	SHTET	K-34-125-(117-A)	VENDRESHË	Skrapar	Skrapar	53,241.54	4,284.00	330.00
714	270/15	3756	PA FRYT	SHTET	K-34-125-(119-A)	QENDËR SKRAPAR	Skrapar	Skrapar	256.93	225.00	35.00
715	310/5	3756	PA FRYT	SHTET	K-34-125-(119-A)	QENDËR SKRAPAR	Skrapar	Skrapar	1,166.95	1,166.00	287.00
716	310/6	3756	PA FRYT	SHTET	K-34-125-(119-A)	QENDËR SKRAPAR	Skrapar	Skrapar	1,418.19	1,142.00	205.00
717	310/7	3756	PA FRYT+TRUALL	SHTET	K-34-125-(119-A)	QENDËR SKRAPAR	Skrapar	Skrapar	2,027.33	364.00	-
718	323/35	3756	PA FRYT	SHTET	K-34-125-(118-B)	QENDËR SKRAPAR	Skrapar	Skrapar	500.38	135.00	21.00
719	328	3756	PA FRYT	SHTET	K-34-125-(118-A)	QENDËR SKRAPAR	Skrapar	Skrapar	43,615.75	2,136.00	84.00
720	55/43	1355	RRUGË	SHTET	K-34-114(254-B)	PROGER	Devoll	DEVOLL	9,469.33	597.00	92.00
						TOTALI			**10.318.602,75**	**512.205,00**	**73.859,00**

VENDIM
Nr. 803, datë 30.9.2015

PËR VËNIEN NË DISPOZICION TË SHOQËRISË TRANS ADRIATIC PIPELINE AG (TAP AG), NËPËRMJET MARRJES NË PËRDORIM TË PËRHERSHËM TË SIPËRFAQEVE TË TOKAVE SHTETËRORE QË PREKEN NGA NDËRTIMI I INFRASTRUKTURËS MBI TOKË TË PROJEKTIT TË GAZSJELLËSIT TRANS ADRIATIK (PROJEKTI TAP)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 16 e 27.1, të marrëveshjes me qeverinë e vendit pritës dhe të pjesëve 1 e 3, të shtojcës 1, të marrëveshjes me qeverinë e vendit pritës, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe Trans Adriatic Pipeline AG, lidhur me projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP), ratifikuar me ligjin nr. 116/2013, "Për ratifikimin e marrëveshjes me qeverinë e vendit pritës, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe Trans Adriatic Pipeline AG, lidhur me projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP), si dhe të marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, dhe Trans Adriatic Pipeline AG, në lidhje me projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (projekti TAP)", me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Vënien në dispozicion të shoqërisë Trans Adriatic Pipeline AG (TAP AG), nëpërmjet marrjes në përdorim të përhershëm me kompensim të sipërfaqes së tokës shtetërore prej 50 867 (pesëdhjetë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) m^2, që preken nga ndërtimi i infrastrukturës mbi tokë të projektit të Gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP).

2. Vendosja në dispozicion të shoqërisë Trans Adriatic Pipeline AG (TAP AG) e sipërfaqes së tokës shtetërore do të bëhet nëpërmjet marrjes në përdorim të përhershëm, me kompensim, sipas planit për rehabilitimin e jetesës, përcaktuar në përputhje me pikën 2, të pjesës 3, të shtojcës 1 të marrëveshjes me qeverinë e vendit pritës, ratifikuar me ligjin nr. 116/2013, të sipërfaqes prej 50 867 (pesëdhjetë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) m^2 dhe me vlerë totale kompensimi prej 20 587 159.00 (njëzet milionë e pesëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e pesëdhjetë e nëntë) lekësh për tokat shtetërore publike, të kategorizuara si toka bujqësore, rrugë automobilistike, si dhe kanal, të përcaktuara në shtojcën 1 bashkëlidhur këtij vendimi, referuar hartave dhe planeve përkatëse të rilevimit.

3. Sipërfaqja e tokës shtetërore, që do të vendoset në dispozicion të përhershëm të shoqërisë TAP AG, sipas formës së përdorimit me vlerën përkatëse të kompensimit, të përcaktuar në pikën 2 për ndërtimin e infrastrukturës mbi tokë të projektit TAP, përfshihet në territorin administrativ të njësive të qeverisjes vendore, si më poshtë vijon:

a) Në territorin administrativ të Bashkisë Skrapar, të Qarkut të Beratit, për:

i) sipërfaqen tokë bujqësore (arë dhe ledh) prej 1 302 (një mijë e treqind e dy) m^2, me vlerë të përgjithshme kompensimi prej 289 044.00 (dyqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e dyzet e katër) lekësh;

ii) sipërfaqen rrugë automobilistike prej 55.00 (pesëdhjetë e pesë) m^2, me vlerë të përgjithshme kompensimi prej 56 000.00 (pesëdhjetë e gjashtë mijë) lekësh.

b) Në territorin administrativ të Bashkisë Devoll, të Qarkut të Korçës, për:

i) sipërfaqen tokë bujqësore (arë) prej 856.00 (tetëqind e pesëdhjetë e gjashtë) m^2, me vlerë të përgjithshme kompensimi prej 192 656.00 (njëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekësh;

ii) sipërfaqen kanal prej 13 374 (trembëdhjetë mijë e treqind e shtatëdhjetë e katër) m^2, me vlerë të përgjithshme kompensimi prej 2 621 304.00 (dy milionë e gjashtëqind e njëzet e një mijë e treqind e katër) lekësh;

iii) sipërfaqen rrugë automobilistike prej 249,00 (dyqind e dyzet e nëntë) m^2, me vlerë të përgjithshme kompensimi prej 56 000.00 (pesëdhjetë e gjashtë mijë) lekësh.

c) Në territorin administrativ të Bashkisë Fier, të Qarkut të Fierit, për:

i) sipërfaqen tokë bujqësore (arë) prej 14 566 (katërmbëdhjetë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) m^2, me vlerë të përgjithshme kompensimi prej 12 235 440.00 (dymbëdhjetë milionë e dyqind e tridhjetë e pesë mijë e katërqind e dyzet) lekësh;

ii) sipërfaqen kanal prej 8 646 (tetë mijë e gjashtëqind e dyzet e gjashtë) m^2, me vlerë të përgjithshme kompensimi prej 2 170 146.00 (dy milionë e njëqind e shtatëdhjetë mijë e njëqind e dyzet e gjashtë) lekësh;

iii) sipërfaqen rrugë automobilistike prej 11 819 (njëmbëdhjetë mijë e tetëqind e nëntëmbëdhjetë) m2, me vlerë të përgjithshme kompensimi prej 2 966 569.00 (dy milionë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekësh.

4. Për sipërfaqet e tokës shtetërore, që preken nga ndërtimi i infrastrukturës mbi tokë të projektit të Gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP), e cila do të vendoset në dispozicion të përhershëm të shoqërisë TAP AG me kompensim, sipas pikës 1 më sipër, vlera e pagesës së kompensimit të paguhet nga shoqëria TAP AG, në emër të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, për llogari të buxhetit të shtetit si kompensim. Vlera e pagesës për tokën shtetërore llogaritet sipas planit të rehabilitimit të jetesës për marrjen në përdorim të tokës shtetërore. Pagesa për tokën shtetërore nga ana e shoqërisë TAP AG bëhet sipas vlerave të përcaktuara në shkronjat "a", "b" dhe "c", të pikës 3, të këtij vendimi, në bazë të një kontrate për pagesën e vlerës së kompensimit, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë dhe shoqërisë TAP AG.

5. Në rast të evidentimit të ndryshimeve të mundshme, gjatë fazës së kryerjes së punimeve të ndërtimit të infrastrukturës mbi tokë të projektit të Gazsjellësit Trans Adriatik (projekti TAP), të cilat sjellin ndryshime në sipërfaqet e tokave shtetërore të vëna në dispozicion të shoqërisë TAP AG, sipas përcaktimeve të këtij vendimi, shoqëria TAP AG do të paraqesë në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë kërkesën për ndryshimet e nevojshme në projekt, së bashku me dokumentacionin përkatës, ku të jenë dhënë edhe ndryshimet që kërkohen të bëhen në sipërfaqet e tokave shtetërore, të vëna në dispozicion të saj në funksion të këtij vendimi.

6. Ministria e Energjisë dhe Industrisë, në bazë të kërkesës së shoqërisë TAP AG për rishikimin e kushteve të lejes për ndryshime në projektin e ndërtimit të infrastrukturës mbi tokë të projektit të Gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP), duke u bazuar në dokumentacionin përkatës, procedon me miratimin e shpejtë të ndryshimeve të nevojshme në lejen për punimet ndërtimore dhe bën njoftimin e ministrive/institucioneve përkatëse, si dhe të njësive të qeverisjes vendore për ato sipërfaqe të tokave shtetërore që janë përfshirë në ndryshimet e projektit të shoqërisë TAP AG.

7. Në përfundim të punimeve të ndërtimit të infrastrukturës mbi tokë të gazsjellësit të projektit TAP, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, në bazë të dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria TAP AG, përgatit dhe paraqet për miratim në Këshillin e Ministrave ndryshimet e mundshme për sipërfaqet faktike të tokave shtetërore dhe efektet financiare që krijohen si rezultat i këtyre ndryshimeve të sipërfaqeve faktike të tokave shtetërore, që janë vënë në dispozicion të shoqërisë TAP AG dhe që preken nga ndërtimi i infrastrukturës mbi tokë të projektit të Gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP).

8. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, për sipërfaqet e tokës shtetërore që do të vendosen në dispozicion të shoqërisë TAP AG për ndërtimin e infrastrukturës mbi tokë të projektit të Gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP), nga ana e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë:

a) të kryhen procedurat për ndryshimin e kategorisë së përdorimit të resursit të tokës bujqësore për sipërfaqet e tokës bujqësore që preken nga ndërtimi i infrastrukturës mbi tokë të projektit TAP;

b) të bëhet njoftimi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për kalimin në shoqërinë TAP AG të sipërfaqeve të tokave shtetërore sipas listave të shtojcës 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

9. Ngarkohen Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, si dhe njësitë e qeverisjes vendore, ku kalon projekti i Gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP), për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Shtojca 1

LISTA E PRONAVE QË PREKEN NGA NDËRTIMI I INFRASTRUKTURËS MBI TOKË TË PROJEKTIT TË GAZSJELLËSIT TRANS ADRIATIK (PROJEKTI TAP) SIPAS NJËSIVE TË QEVERISJES VENDORE QË DO TË KOMPENSOHET

Nr.	Nr. pasurie	ZK	Lloji	Pronari	Indeksi i hartës	Njësia administrative	NJQV	Rrethi	Sip. e pas.	Korridori Perm. AGI		Vlera e bimësisë (lekë)	Kompensimi real (lekë)	Vlera e Kompensimit (lekë)
										Sipërfaqja (m^2)	Kompensimi (lekë)			
1	3/2	3076	ARË	SHTET	K-34-125-(138-A	POTOM	Skrapar	Skrapar	14661	257	53,970.00	3,084.00	57,054.00	57,054.00
2	413	3596	LEDH	SHTET	K-34-125-(100-B)	VENDRESHË	Skrapar	Skrapar	2338	1045	219,450.00	12,540.00	231,990.00	231,990.00
3	799/13	3644	ARË	SHTET	K-34-127-(49-C)	BILISHT	Devoll	Devoll	5849	657	128,772.00	7,884.00	136,656.00	136,656.00
4	799/22	3644	ARË	SHTET	K-34-127-(65-A)	BILISHT	Devoll	Devoll	1491	199	39,004.00	2,388.00	41,392.00	56,000.00
5	6/10	3300	ARË	SHTET	K-34-111-(159-C)	TOPOJE	Fier	Fier	52958	14566	12,060,648.00	174,792.00	12,235,440.00	12,235,440.00
6	1088/7	3644	RRUGË	SHTET	K-34-127	BILISHT	Devoll	Devoll	475.55	249.00	48,804.00	0	48,804.00	56,000.00
7	1852	3644	KANAL	SHTET	K-34-127-(65-A)	BILISHT	Devoll	Devoll	1,782.09	1,274.00	249,704.00	0	249,704.00	249,704.00
8	1908	3644	KANAL	SHTET	K-34-127-(65-A)	BILISHT	Devoll	Devoll	13,615.41	4,032.00	790,272.00	0	790,272.00	790,272.00
9	1558	3787	KANAL	SHTET	K-34-127-65-A	BILISHT	Devoll	Devoll	3,058.22	2,405.00	471,380.00	0	471,380.00	471,380.00
10	1561	3787	KANAL	SHTET	K-34-127-65-A	BILISHT	Devoll	Devoll	7,530.09	2,010.00	393,960.00	0	393,960.00	393,960.00
11	1569	3787	KANAL	SHTET	K-34-127-65-A	BILISHT	Devoll	Devoll	5,993.13	3,653.00	715,988.00	0	715,988.00	715,988.00
12	114	3300	RRUGË + KANAL	SHTET	K-34-111-(159-C,159-D)	TOPOJE	Fier	Fier	6,062.43	4,412.00	1,107,412.00	0	1,107,412.00	1,107,412.00
13	115	3300	RRUGË	SHTET	K-34-111-(159-C,159-D)	TOPOJE	Fier	Fier	5,295.29	3,345.00	839,595.00	0	839,595.00	839,595.00
14	154	3300	KANAL	SHTET	K-34-111-(175-B)	TOPOJE	Fier	Fier	9,047.80	3,147.00	789,897.00	0	789,897.00	789,897.00
15	155	3300	KANAL	SHTET	K-34-111-(175-B)	TOPOJE	Fier	Fier	6,790.77	5,499.00	1,380,249.00	0	1,380,249.00	1,380,249.00
16	3/8	3300	RRUGË	SHTET	K-34-111-(159-D)	TOPOJE	Fier	Fier	5,363.76	4,062.00	1,019,562.00	0	1,019,562.00	1,019,562.00
17	412	3596	RRUGË	SHTET	K-34-125-(100-B)	VENDRESHË	Skrapar	Skrapar	841.49	55.00	5,995.00	0	5,995.00	56,000.00
								TOTALI		**50867**				**20,587,159.00**

VENDIM
Nr. 805, datë 30.9.2015

PËR KUSHTET DHE MËNYRËN E MBROJTJES SË VEÇANTË TË PUNONJËSIT TË POLICISË USHTARAKE NË FORCAT E ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, KUR, PËR SHKAK TË DETYRËS, I KËRCËNOHEN JETA, FAMILJA DHE PRONA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 42, të ligjit nr. 13/2015, "Për Policinë Ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Punonjësit të Policisë Ushtarake, që, për shkak të detyrës, i kërcënohen jeta, familja dhe prona, i sigurohet mbrojtje e veçantë nga Policia Ushtarake.

2. Me mbrojtje të veçantë sipas këtij vendimi nënkuptohen masat me karakter organizativ e profesional për sigurimin dhe ruajtjen e veçantë fizike, mbrojtjen e familjes e të pronës së punonjësit.

3. Punonjësi i kërcënuar paraqet kërkesë me shkrim për mbrojtje të veçantë të shoqëruar, sipas rastit, me certifikatën familjare. Kërkesa me shkrim duhet të përmbajë:

a) gjenealitetet e plota të punonjësit;

b) faktet dhe rrethanat, që përbëjnë rrezik për punonjësin, si dhe burimin e provave ku bazohen ato;

c) llojin e masës mbrojtëse dhe kohëzgjatjen e saj.

4. Kushtet për të përfituar mbrojtje të veçantë janë:

a) Ekzistenca e rrethanave që rrezikojnë jetën, familjen dhe pronën e punonjësit;

b) Ekzistenca e lidhjes shkakësore ndërmjet rrethanave dhe ushtrimit të detyrës nga punonjësi.

5. Për vlerësimin e kërcënimit dhe për mënyrën e sigurimit të mbrojtjes, ngrihet një komision i posaçëm i cili përbëhet nga:

a) Komandanti i Policisë Ushtarake kryetar;

b) Zëvendëskomandanti i Policisë Ushtarake anëtar;

c) Shefi i Shtabit të Policisë Ushtarake anëtar;

ç) Shefi i Policisë Gjyqësore anëtar;

d) Shefi i Policisë Kriminale anëtar;

dh) Shefi i Operacioneve anëtar;

e) Eprori i drejtpërdrejtë i punonjësit të kërcënuar anëtar;

ë) Shefi i personelit sekretar.

6. Komisioni duhet të mblidhet jo më vonë se 48 orë nga data e paraqitjes së kërkesës për mbrojtje të veçantë, ku vendos pranimin ose jo të kërkesës dhe marrjen e masave të menjëhershme për të garantuar jetën, familjen ose pronën e punonjësit, sipas rastit. Në vendim përcaktohen, sipas rastit, masat konkrete të mbrojtjes së veçantë, afati brenda të cilit sigurohet mbrojtja, si dhe masa të tjera të nevojshme.

7. Masat konkrete për mënyrën e mbrojtjes së veçantë janë:

- ruajtja fizike;
- ruajtja e banesës ose e pronës;
- transferimi i punonjësit;
- dërgimi jashtë shtetit i punonjësit;
- masa të tjera, në varësi të çështjes.

8. Mbledhjet e komisionit janë të vlefshme kur janë të pranishëm jo më pak se katër anëtarë të tij. Vendimet janë të vlefshme kur miratohen të paktën nga katër anëtarë, të pranishëm në mbledhje.

9. Në rastet kur nevojitet marrja e menjëhershme e masave të mbrojtjes së veçantë, kjo bëhet me urdhër të Komandantit të Policisë Ushtarake, deri në marrjen në shqyrtim nga komisioni i vlerësimit.

10 Vendimi i komisionit të vlerësimit zbatohet nga Komandanti i Policisë Ushtarake dhe brenda 3 (tri) ditëve vihen në dijeni Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe ministri i Mbrojtjes.

11. Kundër vendimit të komisionit të vlerësimit, i interesuari mund të bëjë ankim, brenda 5 (pesë) ditëve te Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, i cili vendos lënien në fuqi ose ndryshimin e vendimit.

12. Shpenzimet për mbrojtjen e veçantë të punonjësit të kërcënuar përballohen nga buxheti për Policinë Ushtarake.

13. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura dhe Policia Ushtarake për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

UDHËZIM
Nr. 4, datë 30.9.2015

PËR MIRATIMIN E KOSTOS MESATARE TË NDËRTIMIT TË BANESAVE NGA ENTI KOMBËTAR I BANESAVE, PËR VITIN 2015

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës "dh", të nenit 34/1, të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004, "Për programet sociale të strehimit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

UDHËZON:

1. Miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, në shkallë Republike, për vitin 2015, e cila të jetë 39 587 (tridhjetë e nëntë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë/m^2, për sipërfaqe shfrytëzimi.

2. Kostoja mesatare e ndërtimit dhe vlera mesatare e apartamenteve në tregun e lirë të banesave, sipas qyteteve, për vitin 2015, të jetë sipas tabelave nr. 1, nr. 2 e nr. 3, që i bashkëlidhen këtij udhëzimi.

3. Për qytetet, për të cilat nuk janë nxjerrë vlerat e kostos mesatare të ndërtimit, të merren vlerat e kostos së ndërtimit të qytetit më të afërt, sipas tabelës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

4. Vlerat mesatare të banesave në tregun e lirë nuk mund të përdoren për t'iu referuar zonave të afërta.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Tabela nr. 1
Kosto mesatare e ndërtimit
Në koston mesatare nuk janë përfshirë vlerat e:
1. rrjetit inxhinierik;
2. projektit;
3. studimit gjeologjik dhe sizmik;
4. lejes së ndërtimit;
5. truallit;
6. shpenzime operacionale të EKB 4%.

Nr.	Qyteti	Kosto mesatare (aritmetike)	
		Sip. shfrytëzimi lekë/m^2	Sip. ndërtimi lekë/m^2
1	ELBASAN	39,464	32,335
2	GRAMSH	39,464	32,335
3	LIBRAZHD	39,536	32,395
4	PËRRENJAS	39,536	32,395
5	PEQIN	39,464	32,335
6	POGRADEC	39,528	32,384
7	KORÇË	39,528	32,384
8	ERSEKË	39,736	32,556
9	TIRANË	39,193	32,113
10	DURRËS	39,185	32,107
11	KAVAJË	39,185	32,107
12	LUSHNJË	38,291	31,360
13	FIER	38,578	31,599
14	VLORË	39,678	32,516
15	BERAT	39,442	32,317
16	KUÇOVË	39,442	32,317

17	ÇOROVODË	39,442	32,317
18	PËRMET	39,806	32,616
19	TEPELENË	39,806	32,616
20	GJIROKASTËR	39,806	32,616
21	SARANDË	39,959	32,743
22	KRUJË	39,679	32,511
23	LAÇ	39,593	32,440
24	LEZHË	39,593	32,440
25	RRËSHEN	39,860	32,661
26	SHKODËR	39,843	32,648
27	PUKË	40,112	32,870
28	KUKËS	40,154	32,901
29	TROPOJË	40,154	32,901
30	BURREL	40,066	32,831
31	PESHKOPI	40,066	32,831
	KOSTOJA MESATARE	**39,587**	**32,435**

Tabela nr. 2
Vlerat mesatare të shitblerjeve të banesave në tregun e lirë për vitin 2015 sipas qyteteve

Nr.	Qyteti	lekë/m² sipërfaqe shfrytëzimi
1. Qarku Tiranë		
1	Tiranë	89,125
2	Vorë	51,500
3	Kamëz	51,700
4	Kavajë	56,384
5	Rrogozhinë	41,000
2. Qarku Durrës		
6	Durrës	68,540
7	Krujë	48,500
8	Shijak	41,066
9	Sukth	41,000
10	Fushë-Krujë	51,000
3. Qarku Shkodër		
11	Shkodër	58,000
12	Pukë	22,000
13	Vau Dejës	24,300
14	Koplik	40,500
15	Fushë - Arrëz	7,500
4. Qarku Vlorë		
16	Vlorë	59,400
17	Orikum	60,000
18	Selenicë	25,000
19	Himarë	56,000
20	Sarandë	53,300
21	Delvinë	26,750
22	Konispol	28,000
5. Qarku Korçë		
23	Korçë	45,816
24	Pogradec	49,956
25	Bilisht	35,000
26	Ersekë	26,673
27	Maliq	27,800
28	Leskovik	21,000
6. Qarku Fier		
29	Fier	53,030
30	Lushnjë	40,100

31	Ballsh	30,100
32	Patos	28,000
33	Divjakë	49,000
34	Roskovec	30,000
7. Qarku Berat		
35	Berat	41,000
36	Kucovë	38,000
37	Poliçan	26,000
38	Çorovodë	25,000
39	Ura - Vajgurore	37,300
8. Qarku Elbasan		
40	Elbasan	50,200
41	Librazhd	44,020
42	Cërrik	38,300
43	Gramsh	43,023
44	Peqin	39,070
45	Prrenjas	41,780
46	Belsh	35,000
9. Qarku Gjirokastër		
47	Gjirokastër	47,860
48	Përmet	36,867
49	Tepelenë	32,500
50	Memaliaj	15,000
51	Këlcyrë	24,600
52	Libohovë	28,400
10. Qarku Lezhë		
53	Lezhë	56,000
54	Laç	42,500
55	Mamurras	31,000
56	Rrëshen	42,000
57	Rubik	29,500
11. Qarku Kukës		
58	Kukës	53,700
59	Bajram Curri	27,890
60	Krumë	24,500
12. Qarku Dibër		
61	Peshkopi	48,563
62	Burrel	44,357
63	Bulqizë	42,904
64	Klos	32,000
Komunat		
65	Komuna Shëngjin	55,000
66	Komuna Milot	34,200
67	Komuna Krrabë	28,200
68	Komuna Kashar	52,500
69	Komuna Dajt	53,000
70	Komuna Farkë	64,500

Tabela nr. 3
Të dhënat e tregut të lirë të apartamenteve
në qytetin e Tiranës për vitin 2015

Nr.	Zonat	Lekë/m² sipërfaqe shfrytëzimi
1	1/1	98,000
2	1/2	80,000
3	2/1	187,000
4	2/2	135,000
5	2/3	95,000
6	2/4	110,000
7	2/5	80,000
8	3/1	75,000
9	3/2	60,000
10	4/1	70,000
11	4/2	60,000
12	5/1	190,000
13	5/2	131,700
14	5/3	107,000
15	5/4	80,000
16	6	65,000
17	7/1	120,000
18	7/2	100,000
19	7/3	85,000
20	7/4	65,000
21	8/1	110,000
22	8/2	100,000
23	8/3	72,000
24	9/1	130,000
25	9/2	100,000
26	9/3	75,000
27	10/1	145,000
28	10/2	140,000
29	10/3	100,000
30	11/1	87,000
31	11/2	75,000
32	11/3	70,000

URDHËR
Nr. 6119, datë 28.9.2015

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të nenit 102, pikës 4, të Kushtetutës, nenit 7, pikës 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", i ndryshuar, të nenit 27, të ligjit nr. 8485, datë 12.5,1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Drejtësisë nga data 29.9.2015 deri në datën 2.10.2015, zëvendësministrit të Drejtësisë z. Idlir Peçi.

2. Ngarkohet zëvendësministri, z. Ildir Peçi, për zbatimin e këtij urdhri.

3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Nasip Naço

KËRKESË
Nr. 49/43, datë 25.9.2015

PËR SHPRONËSIM ME INTERES PUBLIK

Ministria e Energjisë dhe Industrisë shpall kërkesën për shpronësim me interes publik të pasurive të paluajtshme të tipit "arë, pyll" që preken nga "Ndërtimi i tri shtyllave për përçimin e energjisë elektrike, pjesë e marrëveshjes, të datës 1.7.2015, të shoqërisë koncesionare "Lengarica & Energy" sh.p.k. me "Operatorin e Sistemit të Transmetimit" sh.a. "Për lidhjen me rrjetin e transmetimit"".

Subjekti kërkues i këtij shpronësimi është "Lengarica&Energy" sh.p.k., Tiranë.

Me anën e këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat që preken nga ky shpronësim.

Vënia në dijeni konsiston në sipërfaqen e pasurisë që shpronësohet dhe masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit, pranë Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, për personat sipas tabelës së mëposhtme.

Tabela e vendndodhjes së sipërfaqes që do të shpronësohet, vlera e shpronësimit sipas hartës së vlerës të miratuar nga Këshilli i Ministrave me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 514, datë 30.7.2014, e ndryshuar, si dhe lista e pronarëve të pasurisë private për të cilët kërkohet shpronësimi dhe adresat e njohura të tyre.

Nr.	Objekti	Shpronësim definitiv										Vlera totale e kompensimit referuar VKM-së nr. 514 datë 30.07.2014, e ndryshuar	Adresa e pronarit	Shënime
		Emri	Atësia	Mbiemri	Lloji i pasurisë	ZK	Nr. i pasurisë	Sip. e pasurisë (m²)	Sip. për shpronësim definitiv (m²)	Çmimi lekë/m²	Vlera e kompensimit (Lekë)			
1	HEC Lengarica/ Shtylla 171/2	Musa	Riza	Mane	Pyll	1071	399/2	100.000	118	85	10030	10030	Durrës	Nuk jeton
		Zenepe	Riza	Mane									Tiranë	
2	HEC Lengarica/ Shtylla 171/1	Llukan	Vangjel	Bollo	Arë	1071	87/1	2775	80	143	11440	11440	Përmet	
								Shuma në m²	198		Shuma në lekë	21,470		

Brenda 15-ditëve pas publikimit, personat që kanë emrin në listën emërore kanë të drejtën të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë pranë Komisionit të Posaçëm të Shpronësimit.

MINISTRI I ENERGJISË DHE INDUSTRISË
Damian Gjiknuri

KËRKESË
Nr. 4918, datë 28.9.2015

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën "Për shpronësimet për interes publik, të pasurive pronë private që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "By-Pass Vlorë (shtesa)", për objekt dhe truall.

Subjekti kërkues i këtij objekti, është Autoriteti Rrugor Shqiptar. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur, në bazë të vendimit nr. 138, dtë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përllogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë" brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikun, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Ky publikim bëhet për pasurinë e llojit objekt dhe truall. Pronarët do të kompensohen, për efekt shpronësimi, pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të

pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik".

Vlera totale e shpronësimit është 9 832 636 (nëntë milionë e tetëqind e tridhjetë e dy mijë e gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë) lekë.

MINISTRI I TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
Edmond Haxhinasto

Republika e Shqipërisë
Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës
Sektori i Shpronësimeve
Autoriteti Rrugor Shqiptar

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR "BY PASS-VLORË (SHTESA)

Nr.	Pronari			Z. Kad	Nr. pasurisë	Sip. përgj	Truall	Objekt	Çmimi lekë/m²	Vlera totale në lekë	Konfirmimi
	Emri	Atësia	Mbiemri			m²	m²	m²			
1	B/P Haruni			8605	6/257	180	180		8300	1494000	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
2	Bardhyl Haruni			8605	6/257/ND	149		149	55964	8338636	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
										9832636	

VENDIM
Nr. 112, datë 22.09.2015

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "STRELCA ENERGY" SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-et "STRELCA 1" ME FUQI TË INSTALUAR 1504 KW, "STRELCA 2" ME FUQI TË INSTALUAR 325 KW DHE "STRELCA 3", ME FUQI TË INSTALUAR 3520 KW (ME FUQI TOTALE TË INSTALUAR 5349 KW)

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa "a" dhe 110, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të neneve 4, pika 1, germa "a"; 5, pika 1 germa "a"; 10 pika 3 të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 108, datë 9.9.2008 dhe nenit 18, pika 1, germa "a", e "Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.9.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Strelca Energy" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie nga HEC-et "Strelca 1", "Strelca 2" dhe "Strelca 3",

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Strelca Energy" sh.p.k. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik-ekonomik (neni 9, pikat 4.1.4 dhe 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

- dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2);
- dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3);
- dokumentacioni teknik- ekonomik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3),

do të njoftohet subjekti që në bazë të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, t'i paraqesë këto në ERE, brenda afateve të përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licensimin e shoqërisë "Strelca Energy" sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et "Strelca 1" me fuqi të instaluar 1504 kW, "Strelca 2" me fuqi të instaluar 325 kW dhe "Strelca 3", me fuqi të instaluar 3520 kW (me fuqi totale të instaluar 5349 kW).

2. Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 113, datë 22.09.2015

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "C & S ENERGY" SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC "RAPUN 3 & 4" ME FUQI TË INSTALUAR 8857 KW

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa "a" dhe 110, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të neneve 4, pika 1, germa "a"; 5, pika 1 germa "a"; 10, pika 3 të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 108, datë 9.9.2008 dhe nenit 18, pika 1 germa "a" e "Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.9.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "C & S Energy" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe të Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie nga HEC "Rapun 3 & 4",

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "C & S Energy" sh.p.k. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik-ekonomik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.4 dhe 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

- dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2);
- dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3);
- dokumentacioni teknik-ekonomik (neni 9 pika 4.1.3),

do të njoftohet subjekti që në bazë të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, t'i paraqesë këto në ERE, brenda afateve të përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë "C & S Energy" sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Rapuni 3 & 4", me fuqi të instaluar 8857 kW.

2. Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 116, datë 30.9.2015

PËR MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË RREGULLAT E TREGUT SHQIPTAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 98, pika 2; 109 dhe 110/2, të ligjit nr. 43/2015, datë 22.5.2003, "Për sektorin e energjisë elektrike", nenit 26 të

"Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin të bordit të ERE-s, nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 30.9.2015, pasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, në lidhje me një ndryshim në "Rregullat e tregut të energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 68, datë 23.6.2008, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Pika 1 e vendimit nr. 88, datë 30.6.2015, të Bordit të ERE-s, ndryshohet si më poshtë: "Vendimi nr. 93, datë 16.7.2012, do t'i shtrijë efektet deri në datën 31.12.2015".

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë OST, sh.a për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Petrit Ahmeti

KËRKESË

Shtetasja Leonora Kosova, e bija e Namikut dhe e Teftës, e datëlindjes 20.3.1967, kërkon shpalljen të zhdukur të bashkëshortit të saj Artan Liman Kosova, të datëlindjes 11.4.1965 dhe njohjen si datë të zhdukjes së tij datën 14.4.2009.

KËRKUESE
Leonora Kosova

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi "Gjergj Fishta",
pas ish-Ekspozitës"Shqipëria Sot",
Tel: 04 2427005, 04 2427006

Çmimi 532 lekë